

Data _____

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “CyberRecovery (Rinovimi i infrastruktures se datacenter per pajisjet “end of life” ne business continuity”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 32424000-1 -
Infrastruktura e rrjetit**

VLERA E FONDIT LIMIT: 179,794,575 (Njeqind e shtatedhjetë e nente milion e shtateqind e nentedhjetë e kater mije e peseqind e shtatedhjetë e pese) leke pa TVSH ose 1,758,210 (Nje milion e shtateqind e pesedhjetë e tete mije e dyqind e dhjetë) euro pa TVSH. **Referuar kursit te kembimit te B.SH date 13.12.2023 ku 1 euro = 102.26 All.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsvetimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit, konsiston ne perpunimin dhe ruajtjen e sigurt të te dhënave e cila është sfida më e madhe sot, duke ofruar një vizion që IT duhet të jetë i virtualizuar, i automatizuar, i gatshëm dhe i qëndrueshëm. OSHEE sh.a. ka si vizion të saj përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit, ndaj i kushton një kujdes të veçantë shërbimeve të IT.

Nëpërmjet kësaj procedure prokurimi, OSHEE sh.a. kërkon të zhvillojë infrastrukturën e saj të IT në nivelet e reja teknologjike, duke ofruar shërbime dhe performancë të njëjtë në të gjitha vendndodhjet (sitet) e saj të prodhimit. Teknologjia e ofruar duhet të ndihmojë institucionin në

zgjdhjen dhe fleksibilitetin për të planifikuar, konfiguruar, mbështetur dhe optimizuar infrastrukturën e tij të Teknologjisë së Informacionit.

Përfitimi nga zgjidhja duhet të jetë një platformë e unifikuar për ruajtjen e të dhënave block dhe file në mjediset e institucionit HQ site dhe në site sekondar që garanton shërbime IT të pandërprera dhe plotësisht të sigurta. Kjo zgjidhje përfshin edhe ruajtjen e sigurt të të dhënave në një vendodhje të tretë.

Kjo platformë duhet të jetë rezistente (imune) ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve dashakeqe, duke mundësuar vazhdimësinë e biznesit në mënyrë të automatizuar. Kjo realizohet përmes një zgjidhje active-active me akses të dyfishtë në sitet e disponueshme dhe të aksesueshme në kohë reale, e cila do të përballojë me fleksibilitet fluksin e madh të shërbimeve dhe ngarkesën e punës së institucionit. Kjo do të mundësonte zero kohe të humbur dhe asnjë pikë dështimi të infrastrukturës. Nje kopje e përditsuar e të dhënave duhet të jetë gjithmonë e disponueshme dhe të mundësojë ngarkesat e punës së prodhimit në të dy mjediset, duke ruajtur konsistencën e plotë të të dhënave dhe mbrojtjen e tyre.

Zgjdhja duhet të thjeshtojë dhe të automatizojë disponueshmerinë e lartë për të siguruar operacione të vazhdueshme të aplikacioneve dhe të dhënat kritike, qofshin ato block ose file. Nëse një kontrollor dështon në njërin nga sitet, atëherë shërbimet ekzekutohen në mënyrë automatike në kontrollerin e site-t tjetër, pa patur ndërprerje dhe humbje te tyre. Zgjdhja duhet të mundësojë aksesimin e aplikacioneve nëpërmjet rrugës më të shkurtër dhe me performancën më të lartë.

Zgjdhja duhet të jetë e bazuar në arkitekturën container-base, automatizim inteligjent, teknologji të avancuar all NVMe dhe memorje të klasës Intel Optane në përpunimin e të dhënave. Arkitektura all-NVMe do të sjellë përfitime të plota në sistemin e ruajtjes së të dhënave, gjerësinë e brezit me bandë të lartë, ulje të ndjeshme të vonesave të trasmetimit si dhe performancë më të lartë të shërbimeve.

Per sa mesiper kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 70,000,000 (Shtatedhjetë milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2020, 2021, 2022. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën 70,000,000 (Shtatedhjetë milion) leke pa TVSH, duke qëndruar madje brenda normës prej 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, norme shumë më e ulët se ajo që përcaktohet si limit i mundshëm nga LPP 162/2020 date.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 70,000,000 (Shtatëdhjetë milion) leke pa TVSH.

- a) Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje produktesh/shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të produkteve / shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë / realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a. ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme)
- b. ISO 27001:2013 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme)
- c. ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente (per menaxhimin e shërbimeve te teknologjise se informacionit).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2022** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë, duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do të furnizim vendosje dhe konfigurime që kanë ndërthurje me sistemet ekzistuese, që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

Certifikimi **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në tërësi, i cili është tërësisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike;

2.3.3 Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen e produkteve/shërbimeve/garancive. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota dhe detaje për kontaktin dhe referencën e këtij prokurimi. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të lëshuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Argumentimi:

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve/licencimeve specifike që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve/shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / garancive / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues me famë të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikën e tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve/garancive/shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.3.4 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të ketë të punësuar dhe të disponojë si staf të saj personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional CCNP Routing & Switching ose ekuivalent për rrjetin për të mirëmbajtur garancinë për suport për switch ekzistues si dhe upgrade të core switch, access switch si dhe për instalimin/furnizimin me produktet e reja të rrjetit.

- b) Të paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel profesional ose ekuivalent nga prodhuesi për produktin e ofertuar për te instaluar dhe implementuar Storage NVMe të ofertuar.
- c) Të paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel profesional ose ekuivalent për storage Dell Unity ose ekuivalent për te integruar storage dell unity ekzistues tek storage NVMe të ofertuar.
- d) Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar ne nivel profesional CCSE ose ekuivalent për te instaluar, implementuar dhe mirëmbajtur upgrade të Core Firewall ekzistues.
- e) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalent nga prodhuesi për produktin e ofertuar për te instaluar dhe implementuar Server-at e ofertuar.
- f) Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional CCNP Security ose ekuivalent për sigurinë e rrjetit për te instaluar, implementuar dhe mirëmbajtur upgrade te Edge Firewall ekzistues.
- g) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ITIL ose ekuivalent për ofrimin e menaxhimit te shërbimeve IT.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

1. *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm;*
2. *Kontratat e punonjesve dhe CV;*
3. *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit”.*

Në lidhje me certifikatat e kërkuara, pranohen dhe certifikatat ekuivalente të lëshuara nga institucione certifikuese kombëtare ose ndërkombëtare.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

- 1) Për kriterin në piken **a**) duke qene se pjese e prokurimit është garancia për suport për switch ekzistues network “CISCO”, si dhe upgrade të core switch, access switch si dhe për instalimin/furnizimin me produktet e reja të rrjetit, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij, të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Profesional “CCNP” për këtë lloj teknologjie për “Routing and Switching”, duke garantuar AK për mosndërprerje të shërbimit dhe vijimësinë e punës. Kjo shërben për të tërhequr vëmendjen e operatorëve ekonomikë që të jete tepër të specializuar në certifikimet që do paraqesin bashkë me ofertën.
- 2) Për kriterin në pikën **b**) duke qene se pjese e prokurimit është blerja rishtazi me furnizim vendosje e teknologjisë storage NVME, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij, të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për këtë teknologji, duke garantuar AK për instalim e kolaudim të saktë dhe vijimësi në periudhën e garancisë.
- 3) Për kriterin në piken **c**) duke qenë se storage Dell Unity është produkt ekzistues dhe do të vazhdojë të përdoret nga autoriteti kontraktor, atëherë kërkohet staf (të paktën 1 person) me specializim specifik profesional për integrimin teknologjik me produktin e ri storage NVME, duke garantuar AK për integrim të sakte dhe vijimësi në periudhën e garancisë.
- 4) Për kriterin në pikën **d**) duke qenë se pjese e prokurimit është instalimi dhe mirëmbajtja e procesit të upgrade të zgjidhjes ekzistuese të network Core Firewall “CheckPoint”, duke qenë se ky proces kërkon volum pune dhe kohëzgjatje të konsiderueshme, është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e tij, të paktën 2(dy) specialistë të certifikuar në nivel ekspert (CCSE) ose ekuivalent për këtë lloj teknologjie, të cilat kanë një rëndësi të madhe për sigurinë kibernetike, duke garantuar AK për mosndërprerje të shërbimit dhe vijimësinë e punës.
- 5) Për kriterin në piken **e**) duke qene se pjese e prokurimit është blerja rishtazi me furnizim vendosje e teknologjisë server rackmount (në sasinë 4 copë), meqenëse vlera e këtyre pajisjeve është relativisht e konsiderueshme në krahasim me atë të fondit limit total, bëhet e domosdoshme që OE të ketë në stafin e tij, të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për këto servera, duke garantuar AK për instalim e kolaudim të sakte dhe vijimësi në periudhën e garancisë.
- 6) Për kriterin në piken **f**) duke qene se pjese e prokurimit është upgrade i zgjidhjes ekzistuese të Edge Firewall, duke qenë se ky proces kërkon volum pune dhe kohëzgjatje të konsiderueshme, është e domosdoshme që OE të ketë një stafin e tij, të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi në nivel Profesional “CCNP” ose ekuivalent për këtë lloj teknologjie, duke garantuar AK për upgrade të saktë, mosndërprerje të shërbimit dhe vijimësinë e punës. Bëjmë sqarimin se certifikimet e kërkuara janë tepër të specializuara dhe të dedikuara, ndaj kjo shërben për të tërhequr vëmendjen e operatorëve ekonomik që të jete tepër të specializuar në certifikimet që do paraqesin bashkë me ofertën.
- 7) Për kriterin në piken **g**) duke qene se produktet e kërkuara janë pajisje TIK, me sasi e vlerë të konsiderueshme dhe të gjitha këto se bashku janë pjese e një sistemi/infrastruktura TIK, i cili/të

cilat në mënyrë me profesionale menaxhohen nga specialisti i certifikuar ITIL ose ekuivalent duke ofruar ekspertizën e tij TIK në mënyrë që ky sistem të jete sa më i dobishëm në këndvështrimin e organizimit të përdorimit të tij nga grupet e punës së autoritetit kontraktor, atëherë behet e nevojshme kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent në fushën e IT.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej sistemeve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore që zgjerojnë ato ekzistuese dhe upgrade (përmirësim) të sistemeve ekzistuese sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Termat e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Njesia e Prokurimit